



REGIONAL OFFICE FOR

**World Health
Organization****Europe****Pristina Office****Instituti Kombëtar i
Shëndetësisë Publike
të Kosovës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstvo / Ministry of Health			
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës			
Nacionalni Institut Javnog Zdravstva Kosova			
National Institute of Public Health of Kosovo			
Njësia org.	01	Nr. Prot.	233
Org. Jedin.		Br. Prot.	
Org. Unit		Prot. No	
Nr. i faqeve	2	Data	20.02-2020
Br. Stranka		Datum	
No. Page		Date	
Prishtine/a			

Memorandum Mirëkuptimi**në mes****Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Prishtinë****dhe****Organizatës Botërore të Shëndetësisë, zyra në Prishtinë****HYRJE**

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka punuar dhe ka ofruar mbështetje teknike Institutit të Shëndetit Publik prej qeshorit 1999. Gjatë kësaj periudhe, OBSH gjithmonë ka mbajtur prezencë fizike në ndërtesën e IKSHPK-së, ku një apo dy dhoma janë ofruar për përdorim të OBSH-së, varësisht prej nevojës. Gjatë shtatëmbëdhjetë viteve të fundit (2003-2020), IKSHPK ka ofruar pesë dhoma për nevojat e zyrës së OBSH-së në Prishtinë.

IKSHPK dhe OBSH kanë shprehur gatishmëri për të vazhduar bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira të themeluar prej vitit 1999. OBSH do të vazhdojë së ofruari mbështetje teknike IKSHPK-së në fusha të ndryshme të shëndetit publik.

Instituti i Shëndetit Publik pajtohet që:

1. T'i ofrojë për shfrytëzim OBSH-se pesë (5) dhoma në ndërtesën kryesore të IKSHPK-së. Prej tyre, katër (4) gjenden në katin përdhesë (me hyrje të veçantë, shih skicën e bashkangjitur) dhe një (1) dhomë në Departamentin e Epidemiologjisë (dhoma no 20).
2. T'i ofrojë OBSH-së katër vende për parkim për automjetet zyrtare.
3. Ky është gjest i vullnetit të mire nga ana e IKSHPK-së dhe nuk do të kërkohej asnjë kompensim.
4. Kjo marrëveshje vlen për një periudhë tre vjeçare, duke filluar nga data **01 mars 2020 deri më 28 shkurt 2025**, me mundësi vazhdimi.
5. OBSH, zyra në Prishtinë, me mjetet e veta, mund të renovojë dhomat në katin përdhesë (të bëjë riparime sipas nevojës për mirëmbajtjen e ndërtesës si dhe sistemeve elektrike, të ujit, ngrohjes etj).
6. Për arsye logjistike dhe sigurie, personeli i IKSHPK-së nuk do të ketë qasje në këto dhoma, për asnjë arsye, pa miratimin paraprak të OBSH-së.
7. Inventari i përgjithshëm i vendosur në këto zyra i përket OBSH-së dhe nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e Zyres Rajonale të OBSH-së.

Organizata Botërore e Shëndetësisë pajtohet që:

1. T'i bartë/mbulojë shpenzimet e mirëmbajtjes dhe renovimit të dhomave të cekura më lartë (në katin përdhësë).
2. OBSH do të vazhdojë të ofrojë këshillime teknike dhe mbështetje në çështjet e shëndetit publik nëpërmes të prezencës së saj në Kosovë. Këshilltarët vizitues do të jenë të vendosur në IKSHPK, që të sigurojnë bashkëpunim të vazhdueshëm në çështjet me rëndësi për shëndetin publik.
3. T'i mirëmbajë dhomat në gjendje të mire dhe të riparojë çdo dëmtim që mund të ndodh si shenjë pakujdesie nga ana e OBSH-se.

Kjo marrëveshje do të ri-shqyrtohet dhe nënshkruhet për çdo 5 vjet në vazhdim.

 20.02.2020
(nënshkrimi dhe data)

Dr Sergy KORYAK
Zyrtar Ndërlidhës
OBSH Prishtinë


(nënshkrimi dhe data)
Prof. Dr. Naser Ramadani
Drejtor, IKSHPK

Shënim: Të nënshkruhet edhe kopja në gjuhën angleze.